

Vendim nr. 149 datë 28.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 28.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ERMAL ALLA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i nenit 17 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 17, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “a”, 132, pika 1 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 12 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”; neni 50, pika 4, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar (*ligji nr. 8454/1999*) ka për objekt përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Avokatit të Popullit (*neni 1*). Ai, gjithashtu, parashikon detyrat e këtij të fundit në drejtim të mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj (*neni 2, pika 1*). Në kreun III të ligjit rregullohen ankesat, rregullat e shqyrtimit të çështjeve dhe kompetencat e Avokatit të Popullit në këtë drejtim. Sipas nenit 12, çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të ligjshëm nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, kanë të drejtë të ankohen ose të njoftojnë Avokatin e Popullit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës ose lirisë së shkelur, kurse në nenin 14 parashikohen kushtet e pranimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve. Ankesat, kërkesat dhe njoftimet nuk kërkojnë ndonjë formë të caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës dhe çdo shërbim që bëhet nga Avokati i Popullit në këtë drejtim është pa pagesë (nenet 15 dhe 16 të ligjit). Neni 17 i ligjit, që rregullon administrimin e ankesave ose njoftimeve, parashikon se Avokati i Popullit, pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, vendos: a) ta pranojë ose jo çështjen për shqyrtim; b) t’i kthejë përgjigje të interesuarit, duke i treguar të drejtat dhe rrugët nëpërmjet të cilave ai mund ta mbrojë këtë të drejtë; c) t’ia kalojë çështjen organit kompetent, si dhe, në të gjitha këto raste, ai njofton të interesuarit brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës, kërkesës ose njoftimit.

2. Me ankesën e datës 12.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Avokatit të Popullit për të ndërhyrë për sqarimin e situatës së tij në lidhje me mosveprimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) në kthimin e përgjigjes ndaj aplikimit të kërkuesit përmes sistemit e-Albania. Në ankesë është pretenduar se ASHK-ja nuk zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative (KPA), të cilat rivendosin të drejtat kushtetuese dhe ligjore të kërkuesit të cenuara nga regjistrimi i aktit noterial. Sipas ankesës drejtuar Avokatit të Popullit, edhe pse në listën e shërbimeve që ofron ASHK-ja rasti i kërkuesit nuk është i parashikuar, kjo nuk përjashton detyrimin e atij organi publik për të zbatuar dispozitat e KPA-së.

3. Me shkresën nr. K 3/E 4-2 prot., datë 21.03.2024, Avokati i Popullit, bazuar në nenin 17, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454/1999, ka rekomanduar kërkuesin që fillimisht të konsumojë

rrugën e ankimit administrativ, sipas nenit 65 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për kadastrën”, duke ushtruar ankim në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së. Sipas Avokatit të Popullit, referuar objektit të ankesës, njëra nga problematikat e ngritura, ajo për mungesën e parashikimit të rastit të kërkuesit në listën e shërbimeve që ofron ASHK-ja, është e tillë që duhet sjellë fillimisht në vëmendjen e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

4. Me kërkesën e datës 26.04.2024, përmes shërbimit postar, kërkuesi Ermal Alla i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mbështetje të kërkesës së tij drejtuar Gjykatës, ka parashtruar sa vijon:

5.1. *Për legjitimimin:*

5.1.1. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, edhe pse nuk ka qenë pjesë e asnjë procesi gjyqësor, pasi dispozita e kundërshtuar cenon të drejtën e tij për të përfituar mbrojtjen nga Avokati i Popullit. Ai legjitimohet *ratione temporis*, pasi është vënë në dijeni të cenimit në datën 21.03.2024 nëpërmjet shkresës “Kthim përgjigje” të Avokatit të Popullit dhe ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor. Kërkuesi nuk ka asnjë mjet tjetër në dispozicion për rivendosjen e së drejtës përveç kërkesës drejtuar Gjykatës.

5.2. *Për themelin e pretendimeve:*

5.2.1. Neni 17 i ligjit nr. 8454/1999 është në kundërshtim me nenin 60, pika 1, të Kushtetutës dhe nenin 12 të ligjit organik të Avokatit të Popullit, që përcaktojnë se ky i fundit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike.

5.2.2. Neni 17 i ligjit nr. 8454/1999 i mohon kërkuesit të drejtën kushtetuese të parashikuar nga neni 15 i Kushtetutës, duke i mohuar të drejtën për të përfituar mbrojtje nga Avokati i Popullit për cenimet nga organet dhe administrata publike. Mospërcaktimi i kriterëve të pranimit të ankesës i jep mundësinë Avokatit të Popullit të trajtojë ankesat e individëve në mënyrë selektive dhe jo sipas detyrimeve kushtetuese e ligjore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Kjo dispozitë kushtetuese është zbërthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a).

7. Sipas Gjykatës, bazuar në nenet 49, pika 3, shkronja “e” dhe 71, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe ligji ose akti normativ. Në këto raste, kërkuari legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: (i) *legjitimimi ratione personae*, në kuptimin që individi provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar, si dhe provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese; (ii) *shterimi i mjeteve juridike efektive* për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose individi provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; (iii) *legjitimimi ratione temporis*, në kuptimin që individi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit; (iv) *legjitimimi ratione materiae*, në kuptimin që individi provon se pretendimet e ngritura janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, pra të drejtat dhe liritë themelore, që pretendohen se janë cenuar, janë të garantuara në Kushtetutë, si dhe shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Për qëllime të legjitimitimit, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, në rastin e pretendimeve për papajtueshmëri të ligjit me Kushtetutën, kërkuari duhet të provojë se është viktimë e shkeljes dhe se zbatimi i dispozitave të ligjit të kundërshtuar cenon interesat e tij, duke sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale. Kërkuari

mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje nëse atij i kërkohet të modifikojë sjelljen e tij ose rrezikon të procedohet për mosrespektim të ligjit (*shih vendimin nr. 1, datë 25.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kolegji vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e nenit 17 të ligjit nr. 8454/1999, i cili parashikon se çfarë vendos Avokati i Popullit pasi njihet me ankesën, kërkesën apo njoftimin për një shkelje, për shkak të mënyrës se si ka trajtuar ky institucion ankesën e kërkuesit ndaj mosveprimeve të ASHK-së në lidhje me aplikimet e tij. Kolegji vlerëson se, pavarësisht se kjo dispozitë ka gjetur zbatim në trajtimin e rastit të kërkuesit, ajo nuk e prek atë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale, për sa kohë nuk është provuar se sjell ndonjë pasojë në drejtim të të drejtave të tij kushtetuese. Edhe pse kërkuesi e ka lidhur ankimin kushtetues individual me të drejtën për të përfituar nga mbrojtja kushtetuese e Avokatit të Popullit, siç është parashtruar në kërkesë, por dhe siç rezulton nga aktet bashkëlidhur asaj, ai e ka ushtruar këtë të drejtë duke paraqitur ankesë pranë atij institucioni dhe duke marrë përgjigje të arsyetuar në lidhje me ankesën e tij. Mënyra se si e ka trajtuar Avokati i Popullit ankesën dhe përgjigja që i ka kthyer kërkuesit bazuar në parashikimet e nenit 17, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454/1999, nuk është provuar të ketë sjellë asnjë pasojë në të drejtën e tij të pronës private, e cila, sipas kërkesës, rezulton të jetë e drejta kushtetuese që ai kërkon të mbrojtë përmes procedurave administrative.

10. Neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës nuk parashikon të drejtën e paraqitjes së një *actio popularis* dhe nuk lejon që individët të kundërshtojnë një akt të pushtetit publik pa qenë të prekur drejtpërdrejt prej tij, pra vetëm sepse e konsiderojnë si të papajtueshëm me Kushtetutën. Në këtë kuptim, kërkuesi nuk mund t’i drejtohet kësaj Gjykate në mënyrë të drejtpërdrejtë për kundërshtimin e ligjit objekt kërkesë, por ai duhet të paraqesë një akt individual negativ (ose ndalues) të dalë në zbatim të këtij ligji, nga i cili t’i ketë ardhur një pasojë negative konkrete, që duhet ta kundërshtojë gjyqësisht bashkë me dispozitat ligjore që i konsideron të papajtueshme me Kushtetutën.

11. Për sa më sipër Kolegji vlerëson se kërkuesi, duke mos arritur të provojë pasojat e drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tij kushtetuese për shkak të përmbajtjes së dispozitës së kundërshtuar, nuk mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes, për rrjedhojë nuk legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, për sa kohë nuk provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione personae* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

13. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.